



FKEE

FONDIT I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EF-KASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
FONDIT I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EF-KASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND
ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE

Nr.Br.No. 2025/29

Nr. i fq./Br.Str./No.pg. - 19 -

Data/Datumi/Date: 01.11.24

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 01 / 11 / 2024			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01	53136	

Marrëveshje Bashkëfinancimi

Ndërmjet

Fondit për Eficiencë të Energjisë

dhe

Komunës së Drenasit/Gllogocit

për

**Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë-
Banesore Sociale -II-**

Data: 01/11/2024

Hyrje

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (këtu e tutje "FKEE") zbaton projektin që synon përmirësimin e kursimit të energjisë dhe komfortit në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të IPA-s - Pakos së Mbështetjes për Energji, të aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian më datë 24 shkurt 2023 kanë nënshkruar Marrëveshjen për Ndihmë Financiare IPA III e cila, ndër programe të tjera, ka për objektive sigurimin e qasjes në energji të përballueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës (Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 7);

Qeveria e Kosovës përmes vendimit Nr.29/112 të datës 13.12.2022, duke ndryshuar dhe plotësuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, e cila përfshin Masën 3 – "Mbështetja e konsumatorëve individualë familjarë, duke përfshirë konsumatorët në nevojë përmes rritjes së eficiencës së energjisë në njësitë e banimit dhe ndërtesa". Kjo masë zbatohet nga FKEE duke zgjeruar fushëveprimin në sektorin rezidencial.

FKEE zbaton masën për ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave, e cila ka për synim rritjen e eficiencës së energjisë së ndërtesave shumë-banesore, në të cilat banojnë familjet dhe qytetarët e kategorisë sociale dhe të cilat janë në pronësi publike të komunave.

Komuna e Drenasit ka aplikuar për të përfituar nga Masa 3 dhe e njëjta plotëson kriteret e thirrjes Publike të datës 7 prill 2023.

Gjithashtu, komuna pranon rezultatet e tenderit të kryer për punimet e ndërtimit për masat e eficiencës së energjisë (MEE), si dhe bazën themelore të vendosur në raportin e kontrollit të energjisë dhe Masat e Eficiencës së Energjisë (MEE) që do të zbatohen në objektin në pronësi të Komunës dhe nivelin e parashikuar të kursimeve vjetore të energjisë.

Andaj, palët pajtohen të nënshkruajnë këtë Marrëveshje për zbatimin e projektit të eficiencës së energjisë në ndërtesën në pronësi të Komunës (këtu e tutje "projekti"), si vijon:

Bazuar në Ligjin për Eficiencë të Energjisë 06/L-079, për zbatimin e investimeve të efijencës së energjisë në subjektet publike në kuadër të komponentit joqarkullues, Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian në kuadër të programit të IPA III - Pakos së Mbështetjes për Energji, datë 24.02.2023, Thirrjes Publike të FKEE-së për Aplikim - Projekti Emergjent për Masat e Efijencës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në pronësi të Komunave, datë 07.04.2023, Marrëveshjes për Inicim të Projektit Emergjent për Masat e Efijencës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në Pronësi të Komunës lidhur më datë 22.05.2023, më datë 01.11.2024 arrihet:

Marrëveshje Bashkëfinancimi për zbatimin e Masave të Efijencës së Energjisë në Ndërtesa Shumë-Banesore Sociale në pronësi të Komunës

Ndërmjet:

- Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (këtu e tutje "FKEE") e përfaqësuar nga z. Driton Hetemi, Drejtor Menaxhues i FKEE-së, dhe
- Komuna e Drenasit, përfaqësuar nga Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës, (këtu e tutje "Komuna"), së bashku të referuara si "palë".

NENI 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje përcakton bashkëpunimin në mes FKEE-së dhe Komunës së Drenasit për bashkëfinancimin e projektit për zbatimin e masave të efijencës së energjisë për përmirësimin e efijencës së energjisë në Ndërtesa Shumë-Banesore Sociale (këtu e tutje: NSHBS). FKEE në kuadër të projektit të mbështetjes nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të IPA-s - Pakos së Mbështetjes për Energji, të aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i ofron Komunës financim në formë granti (pa kthim) në **90%** të vlerës së projektit, ndërsa komuna do të bashkëfinancojë me **10%** të vlerës së përgjithshme të projektit.

1.1. Shërbimet e ofruara nga FKEE

1.1.1 Shërbimet e ofruara nga FKEE përfshijnë:

- a) Auditimi i energjisë,
- b) Dokumentacioni teknik për implementimin e MEE,
- c) Zbatimi i MEE,
- d) Mbikëqyrja teknike e zbatimit të MEE,
- e) Komisionimi i projektit,
- f) Menaxhimi dhe mbikëqyrja gjatë periudhës së defekteve,
- g) Prokurimi, menaxhimi i kontratës, menaxhimi financiar dhe raportimi i kërkuar për implementimin e MEE,
- h) Sigurimi i financimit për përgatitjen dhe zbatimin e MEE-ve sipas kushteve të thirrjes.

1.1.2 Për zbatimin e shërbimeve që kërkojnë kapacitet profesional, FKEE angazhon kompani të kualifikuara. Për kryerjen e shërbimeve për auditimin e energjisë, projektimin e MEE, punime, mbikëqyrjen teknike dhe mbikëqyrjen e periudhës së defekteve, kompania është përzgjedhur dhe kontraktuar nën tenderin për shërbimet e prokuruar nga FKEE, përmes rregullave të prokurimit publik, kontrata e së cilës është Shtojca 4 e kësaj Marrëveshje dhe e cila është pjesë integrale e saj.

1.1.3 Për zbatimin e MEE-ve, kompania është përzgjedhur nën tenderin për furnizimin e punëve të prokuruar nga FKEE, përmes rregullave të prokurimit publik, kontrata e së cilës do i bashkangjitet pas përfundimit të obligimit të Komunës sipas pikës 1.6.2 të kësaj marrëveshjeje si Shtojca 4 e kësaj Marrëveshje dhe e cila do të behët pjesë integrale e saj.

1.2. Cilësia e shërbimeve

FKEE ofron shërbimet e saj drejtpërdrejt ose përmes kontraktorëve, merr përgjegjësinë e plotë për shërbimet e kryera përmes ekspertëve dhe kontraktorëve të saj. Gjithashtu, siguron Komunën për performancë të mirë të të gjitha punëve të kryera nën këtë marrëveshje dhe funksionimin e duhur të MEE nga pranimi dhe komisionimi (duke përfshirë, instalimet, pjesët e tyre dhe pajisjet e instaluar) si dhe se punët dhe artikujt e tillë (a) janë të reja dhe me cilësi të mirë, (b) nuk kanë defekte në dizajn, material dhe punë; dhe (c) janë të përshtatshme për këtë qëllim. d) nuk dëmtojnë mjedisin.

1.3. Koordinimi në mes të palëve

Me qëllim të koordinimit të punëve FKEE emëron Granit Restelica si menaxher projekti, përgjegjës për koordinimin e shërbimeve, si dhe Komuna emëron përfaqësuesin e autorizuar Lumturije Kiqina sipas kësaj marrëveshjeje. Secila palë do të njoftojë me shkrim palën tjetër për ndryshimet në lidhje me përfaqësimin e autorizuar në këtë marrëveshje.

1.4. Komisionimi dhe Pranimi i Shërbimeve

Shërbimet sipas kësaj marrëveshjeje konsiderohen të përfunduara pas pranimit teknik final, që konfirmohet nga nënshkrimi i të dy palëve në Certifikatën e Pranimit Final.

Pas pranimit teknik final, një seri e plotë e dokumenteve në lidhje me projektin, siç janë raporti i auditimit të energjisë, specifikacionet teknike, të gjitha certifikatat dhe manualët e produkteve të MEE, etj, do t'i sigurohen Komunës.

1.5. Financimi i projektit

1.5.1 Financimi i projektit për 90% të vlerës së përgjithshme do të bëhet nga FKEE nën komponentin joqarkullues si grant (pa kthim), ndërsa 10% e financimit të vlerës së përgjithshme do të bëhet nga Komuna.

1.5.2 Gjithashtu, kostoja për të gjitha shpenzimet e tjera të krijuara apo punët shtesë në kuadër të projektit do të zbatohen sipas parimit që FKEE participon me 90% të vlerës, ndërsa 10% e pagesës bëhet nga Komuna. I njëjti parim vlen edhe në rastin kur shpenzimet dhe kostot e investimit janë më të ulëta se ato të parashikuara.

1.6. Pagesa e shumës së bashkëfinancimit nga Komuna

1.6.1 Shuma e bashkëfinancimit të projektit është **210,824.80** EUR (100%) nga të cilat:

189,742.32 EUR (90%) financohet nga FKEE, dhe
21,082.48 EUR (10%) financohet nga Komuna.

1.6.2 Komuna, shumën në vlerë prej **21,082.48** EUR (10% e totalit të investimit) do ta transferojë në llogarinë bankare të FKEE-së: **FONDI I KOSOVES PER EFICIENCË TË ENERGJISË** me numër **1110350980010125** në bankën **ProCredit Bank (PCB)**, branda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje., branda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

1.6.3 Në rast të punëve shtesë, pas konstatimit të Mbikqyrjes profesionale, situacioni i punëve së bashku me një arsyetim të detajuar prezantohet tek menaxheri i kontratës nga FKEE. Dokumentacioni i plotë i prezantohet edhe përfaqësuesit nga ana e Komunës, ku pas miratimit të dyanshëm pason Amendamenti i Kontratës me Aneks. Mbulimi i kostos së punëve shtesë ndahet në parimin e njëjtë, pra 90% nga FKEE dhe 10% nga Komuna, dhe kjo vlerë kompenzohet sipas aneks marrëveshjes në mes të FKEE-së dhe Komunës brenda afatit të përcaktuar.

1.6.4 Në rast se vlera përfundimtare e projektit është më e ulët se planifikimi fillestar, kthimi i mjeteve nga FKEE tek Komuna, për relacionin 90%-10%, bëhet pas komisionimit të përkohshëm të punimeve, në afatin prej 30 ditësh nga dita e komisionimit (ose përcaktohet afati sipas dakordimit të paleve në aneks kontratë).

1.6.5 Në situatën kur Komuna nuk i përmbushë detyrimet e marra nën këtë Marrëveshje ose i kryen ato vetëm pjesërisht brenda afatit të përcaktuar nga FKEE, e cila rezulton me anulim e kësaj marrëveshje, komuna do të mbulojë plotësisht të gjitha kostot paraprake të shërbimeve që i janë ngarkuar FKEE-së për zhvillimin e projektit (p.sh. auditimi i energjisë, dizajni etj.).

1.7. Standardet e performancës Mjedisore dhe Sociale

1.7.1 Pajtueshmëria me Standardet e Performancës Mjedisore dhe Sociale: Zbatimi i masave të EE në kuadër të projektit sipas kësaj marrëveshjeje do të kryhet në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e Mjedisit, mirëqenien dhe aspektin social të përfituesve.

1.7.2 Palët angazhohen në këtë marrëveshje që ti japin rëndësi të veçantë çështjeve mjedisore, mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit që implementimi i masave EE sjell, duke marrë për bazë dhe dokumentat dhe urdhëresat për menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të FKEE.

1.7.3 Palët angazhohen që të trajtojnë me prioritet të gjitha çështjet sociale dhe ndikimit që implementimi i masave EE sjell në komunitetet përkatëse duke u udhëzuar nga dokumentet dhe urdhëresat për menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të FKEE-së.

NENI 2

Zbatimi Masave të Eficiencës së Energjisë (MEE)

- 2.1 Zbatimi i projektit të MEE-ve në Projektin Komunal të Eficiencës së Energjisë (ne tekstin e mëtejme Projekti) bëhet sipas përcaktimeve të Manualit të Operacioneve për NSHBS të FKEE-së, si dhe masat përkatëse të eficiencës së energjisë që do të zbatohen duke u bazuar në analizën e ndërtesës, të dhënat e konsumit, potencialin për kursim të energjisë dhe nivelin e mirëqenies. MEE-të e zbatuara për këtë projekt përmbledhen në Shtojcën 4 të kësaj marrëveshje, të cilat përcaktohen nga raporti i auditimit dhe projekti.
- 2.2 Gjatë ekzekutimit të punimeve, FKEE mund të ndryshojë ose zëvendësojë ndonjë nga MEEtë ose të zbatojë MEE shtesë me marrëveshje me Komunën, me kusht që:
- 2.2.1 kushtet e vendpunimit të kërkojnë një rishikim të tillë.
- 2.2.2 ndryshimet e tilla janë të nevojshme për të përmbushur objektivin e parashikuar të Kursimeve të Energjisë në vendpunim.
- 2.2.3 operacionet e tilla nuk do të ndryshojnë vlerën e kontratës, nivelin standard të komfortit dhe shpenzimet e investimit pa marrëveshje paraprake me shkrim/aneks kontratë me Komunën.
- 2.3 Komuna nuk lejohet të ndryshojë, zëvendësojë, heqë dhe/ose rregullojë ndonjë MEE ose pjesë të tyre pa miratimin paraprak me shkrim nga FKEE. Përveç detyrimeve të përcaktuara, Komuna do të bëjë përpjekje për të përdorur vendpunishten në mënyrën më të mirë dhe për të mirëmbajtur MEE në kushte të mira, sipas udhëzimeve të prodhuesve dhe të sigurojë funksionimin e duhur të pajisjeve të instaluara.
- 2.4 Koha e zbatimit të MEE është definuar sipas planit dinamik si pjesë integrale e kontratës ndërmjet FKEE dhe Kontraktorit, siç parashikohet në Shtojcën 5 të kësaj marrëveshjeje. FKEE
- do të informojë me shkrim Komunën për çdo rrezik të vonësës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas shkaktimit të vonësës. Në rast të vazhdimit të vonësës së shkaktuar, është i nevojshëm një ri-njoftim.
- 2.5 FKEE dhe Komuna do të mbajnë përgjegjësi për të gjitha humbjet ose dëmtimet, për pengesat ose vonesat gjatë zhvillimit të ndonjë pjesë të punimeve të ndërtimit dhe gjithashtu të gjitha humbjet ose dëmet që vijnë nga natyra e punës që do të ndodhin, nga moti i keq ose nga ndonjë rast i paparashikuar apo i papritur ose nga rrethanat e krijuara në lidhje me punimet e ndërtimit nëse të njëjtat nuk janë shkaktuar nga pakujdesia e kompanisë punëkryese.
- 2.6 Zgjatja e afatit është e lejuar për vonesat të cilat ndikojnë në Planin Dinamik që rrjedhin nga shkaqe të paparashikueshme përtej kontrollit dhe pa fajin ose neglizhencën e FKEE-së dhe komunës. Ndryshimi i marrëveshjes sa i përket zgjatjes së afatit të punimeve bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

NENI 3

Detyrimet e FKEE-së

FKEE do të sigurojë zbatimin e shërbimeve sipas kësaj marrëveshje, dhe është përgjegjëse për të gjitha shërbimet dhe punimet e kryera nga stafi i saj, kontraktorët ose të tjerë të autorizuar nga Fondi.

3.1 Detyrimet e përgjithshme

- 3.1.1 Prokurimi dhe mbikëqyrja e punëve të zbatuara nga Kontraktorët e FKEE-së, duke përfshirë kontrollimin e pajtueshmërisë së rezultateve të punëve të kryera me projektin dhe sasisë, sigurimin e cilësisë së mallrave dhe punëve, Termat e Referencës, rishikimin e raporteve të mbikëqyrësit të ndërtimit, sigurimin e heqjes së duhur të materialeve ndërtimore të rrezikshme, mbrojtjen e mjedisit, kushtet e sigurisë në punë;
- 3.1.2 Monitorimi i realizimit të Projektit, përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve mbi realizimin e tij tek autoritetet dhe donatorët;
- 3.1.3 Ofrimi i dokumentacionit të nevojshëm teknik nga FKEE për Komunën, kur është e nevojshme. Dokumentacioni teknik kërkohet në rastet e aplikimeve për leje dhe aprovime të ndryshme përgjatë zhvillimit të projektit. Megjithatë, FKEE nuk është përgjegjëse për aplikimin për leje dhe zhvillimin e proceduarave, pagesës së taksave, sigurimin e dokumenteve që lëshohen nga vetë Komuna apo çdo çështje tjetër e cila është përgjegjësi ekskluzive e Komunës.
- 3.1.4 Planifikimi dhe koordinimi i realizimit të Projektit me Komuna në mënyrë që të minimizohen devijimet nga planifikimi;
- 3.1.5 Informimi i Komunës sa më herët që është e mundur për çështjet që mund të ndikojnë materialisht në zbatimin e sigurtë ose efikas të Projektit dhe ngjarje specifike të mundshme në të ardhmen ose rrethana që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e punimeve ose të vonojnë ekzekutimin e punimeve.
- 3.1.6 Sigurimi i të gjitha garancioneve dhe certifikatave nga furnizuesit e materialeve dhe pajisjeve për Komunën.
- 3.1.7 FKEE përcjellë nivelin e zbatimit të projektit, do të mbajë të dhëna financiare dhe evidentimin kontabël të transaksioneve financiare në sistemin e kontabilitetit. Sipas nevojës, FKEE përgatit raporte mbi nivelin e zbatimit të projektit dhe ekzekutimit të pagesave.
- 3.1.8 FKEE nuk mban asnjë përgjegjësi për çështjet që ndërlidhen me lejet ndërtimore, të cilat rregullohen sipas legjislacionit në fuqi që rregullon çështjet e ndërtimit, dhe të cilat janë përgjegjësi e Komunës.

3.2 Standardi i Performancës

- 3.2.1 FKEE kryen shërbime me gjithë kujdesin e duhur në mënyrë ekonomike dhe efikase, në përputhje me standardet dhe praktikën e pranuar profesionale të cilësisë, të vëzhgojë praktikën e menaxhimit të mirë dhe të përdorë teknologji të përshtatshme dhe pajisje, makineri, materiale dhe metoda të sigurta dhe efektive;

3.2.2 FKEE punëson dhe siguron staf të kualifikuar dhe me përvojë, siç kërkohet për të kryer Shërbimet;

3.2.3 FKEE mban të informuar Komunën në mënyrë transparente për statusin dhe progresin e shërbimeve.

NENI 4

Detyrimet e Komunës

Për të zbatuar dhe koordinuar këtë marrëveshje, detyrimet e Komunës përfshijnë, por nuk kufizohen në atë si vijon:

4.1 Të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme

4.1.1 Sigurimi i pagesës së vlerës së 10% në kohë për FKEE-në sipas dispozitave të kësaj marrëveshje.

4.1.2 Organizimi itakimeve informuese me banorët përfitues së bashku me FKEE-në ku do të spjegohen punimet që do të kryhen dhe mënyra e përfshirjes së tyre në mbarëvajtjen e punimeve;

4.1.3 Komuna duhet të ketë kujdes për sigurinë e banorëve gjatë kryerjes së punimeve, përfshirë aplikimin e kontrolleve më të shpeshta nga inspektoriati respektiv;

4.1.4 Zhvillon dhe kryen e të gjitha procedurat dhe veprimeve të nevojshme dhe sigurimi nga vetë komuna e vendimit/pëlqimit/aprovimit apo lejes ndërtimore nëse është e domosdoshme për aplikimin e MEE sipas legjislacionit në fuqi për ndërtim dhe që lejojnë fillimin e zbatimit të projektit dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera të ndërlidhura. Vendimi apo leja ndërtimore nëse është e aplikueshme, duhet të sigurohet në kohë dhe para fillimit të zbatimit të projektit për të mos vonuar zbatimin e MEE.

4.1.5 Të ofrojë zgjidhje dhe të aranzhojë logjistikën, për të mundësuar që punët të kryhen sipas dinamikës së planifikuar, në rast të paraqitjes së ndonjë pengese, bazuar edhe në marrëveshjen për incicim të projektit. Kjo përfshinë edhe situatat në të cilat mund të kërkohet zhvendosja e banorëve dhe mbulimi i kosotos së një zhvendosje të tillë.

4.1.6 Bashkëpunimi me FKEE-në dhe Kontraktorët në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit.

4.1.7 Të japë të gjithë informacionin e nevojshëm FKEE-së në të gjitha fazat e projektit, i cili përfshin, por nuk kufizohet në:

4.1.7.1 dokumentacioni teknik ekzistues në lidhje me ndërtesën, si dhe informacionin për mirëmbajtjen e elementeve të përbashkëta të ndërtesës;

4.1.7.2 çdo kërkesë e njohur e vendosur nga rregulloret dhe/ose kërkesat e ndërtimit (teknike), kufizimet që lidhen posaçërisht me ndërtesën që ndryshojnë nga ato që zakonisht zbatohen për ndërtimin; dhe

4.1.7.3 Informacionet kontaktuese me përfaqësuesit e zgjedhur të banorëve në rastet kur ka nevojë;

4.1.7.4 të gjitha informacionet dhe/ose dokumentet e tjera të kërkuara në shërbim të zhvillimit të projektit;

4.1.7.5 Të dhëna të tjera që kërkohen nga FKEE në lidhje me projektin.

- 4.1.8 Vënia në dispozicion e inxhinierëve, personelin mirëmbajtës dhe operativ për intervista me FKEE-në, kontraktorët e tij, si dhe donatorët dhe zyrtarët qeveritarë.
- 4.1.9 Në rast të dëmtimeve të paparashikuara, të cilat nuk janë shkaktuar nga aktivitetet e FKEE-së, ndodhin në ndërtesë gjatë periudhës kontraktuale të kësaj marrëveshje, dhe rehabilitimi i tyre (riparimi ose zëvendësimi) është i nevojshëm për ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale nga FKEE, Komuna është e detyruar të kryejë të gjitha veprimet e kërkuara për rehabilitim, në periudhën më të shkurtër të arsyeshme kohore, dhe të mbajë në përgjegjësi shpenzimet e atij rehabilitimi, për të cilën periudhë, ekzekutimi i detyrimeve kontraktuale të FKEE-së nuk do të pezullohet.
- 4.1.10 Merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e kontrollimit dhe komisionimit të FKEE-së;
- 4.1.11 Të informojë menjëherë FKEE-në sapo të ketë njohuri për çështje që mund të ndikojnë materialisht në detyrimet e FKEE-së ose Komunës sipas kësaj marrëveshje ose të sigurojë funksionimin e sigurtë ose efikas të Projektit;
- 4.1.12 Të ndihmojë FKEE-në në sondazhet para dhe pas zbatimit për të vlerësuar kënaqësinë e përfituesve me zbatimin e projektit;
- 4.1.13 Të sigurojë mirëmbajtjen e ndërtesës sipas legjislacionit në fuqi;
- 4.1.14 T'i përkrah banorët e NSSHB në informimin rreth përdorimit të ndonjë teknologjie të re;
- 4.1.15 Të hartojë një plan menaxhimi dhe mirëmbajtjeje dhe i njejtë të jetë në dispozicion të FKEE-së menjëherë pas kryerjes së punëve për aplikimin e MEE;
- 4.1.16 Komuna obligohet të themelojë një Grup Koordinues për njoftim paraprak të banorëve dhe koordinim gjatë zbatimit të projektit me pjesëmarrës: FKEE, Komuna dhe Përfaqësuesi i Autorizuar i NSHBS-së, i cili përzgjidhet nga vet banorët. Komuna do të jetë kryesuese e këtij Grupi.
- 4.1.17 Siguron hapësirë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për ruajtjen e materialeve dhe pajisjeve në vend-punishte dhe bashkëpunon me FKEE-në dhe Kontraktorët e tij në veprime që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur punën nga dëmtimi, vjedhja ose keqpërdorimi;
- 4.1.18 Siguron që FKEE dhe Kontraktorët të kenë qasje të pa penguar në vend-punishte;
- 4.1.19 Komuna përcakton lokacionin për deponimin e mbeturinave ndërtimore që dalin nga zbatimi i masave EE për të gjitha ndërtesat që janë pjesë e projektit, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i këtij lokacioni bëhet jo më vonë se 20 ditë nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje.
- 4.1.20 Komuna lajmëron FKEE për lokacionin e caktuar me postë elektronike duke specifikuar koordinatat e sakta.
- 4.1.21 Komuna angazhohet të bashkëpunojë me komuna të tjera në mënyrë që , kur është e mundur, të përcaktohet një lokacion i vetëm për deponimin e mbeturinave ndërtimore që dalin nga zbatimi i masave EE në kuadër të këtij Projekti.
- 4.1.22 Caktimi i lokacionit të përkohshëm për vendosjen e materialeve të rrezikshme që dalin nga zbatimi i masave EE duke u bazuar në legjislacionin në fuqi (Ligjin për Mbeturina, plotësim ndryshimet e tij dhe aktet nënligjore). Kjo pikë e marrëveshjes zbatohet vetëm për rastet kur konstatohet prania e këtyre materialeve që në fazën e projektimit ose kur zbulohen materiale të rrezikshme gjatë zbatimit të masave EE.

NENI 5

Ndërprerja e Marrëveshjes

5.1 Ndërprerja e Inicuar nga Komuna

Komuna mund të iniciojë ndërprerjen e Marrëveshjes me të paktën 30 ditë njoftim paraprak ndaj FKEE-së. Marrëveshja konsiderohet e ndërprerë nga data kur FKEE e pranon njoftimin. Në këtë rast, Komuna do të kompensojë të gjitha shpenzimet e FKEE-së të krijuara sipas kësaj Marrëveshjeje deri në datën e njoftimit. Komuna do të kompensojë për punët dhe shërbimet e kryera, si dhe pajisjet dhe materialet e prokuruar. Ndërprerja me iniciativë të Komunës do të lirojë FKEE-në nga të gjitha detyrimet pas datës së ndërprerjes së Marrëveshjes.

5.2 Ndërprerja e Inicuar nga FKEE

Marrëveshja mund të ndërprehet me iniciativë të FKEE-së në çdo moment me kusht që FKEE të kompensojë të gjitha humbjet e Komunës, të krijuara si rezultat i Marrëveshjes. Të gjitha detyrimet e palëve ndalohen në datën e ndërprerjes, përveç detyrimeve të krijuara para datës së ndërprerjes.

5.3 Arsytet e ndërprerjes së marrëveshjes

- 5.3.1 Performanca jo e mirë e FKEE-së dhe/ose ndonjërit prej kontraktorëve të tij;
- 5.3.2 Shkelja e dispozitave të marrëveshjes nga Komuna;
- 5.3.3 Anulimi i projektit për shkak të mos kryerjes së detyrimit të bashkëfinancimit nga Komuna sipas afatit të lartëcekur në pikën 1.6.2 të kësaj marrëveshjeje;
- 5.3.4 Mos zbatimi i Marrëveshjes nga ndonjëra palë.

NENI 6

Përfundimi Parakohshëm i Marrëveshjes

Arsyet e mëposhtme mund të sigurojnë bazë për përfundimin e marrëveshjes:

- 6.1 Vendimi i qeverisë për të mbyllur, zhvendosur, privatizuar, ose ndryshuar thelbësisht ndërtesën e propozuar të Komunës ose për të ndryshuar natyrën e përdorimit të tij;
- 6.2 Vendimi i donatorit për ndaluar financimin e projektit, e që pamundëson që të vazhdohet me implementimin e MEE-së;
- 6.3 Në rastin e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, shpenzimet e krijuara deri në datën e përfundimit të marrëveshjes ndahen sipas parimit të vlerës së investimit të përcaktuar në pikën 1.5 të nenit 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Konflikti i interesit

- 7.1 Përfaqësuesit e Komunës dhe FKEE-së nuk duhet të përfshihen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në ndonjë aktivitet biznesi ose profesional që bie ndesh me aktivitetet e Komunës dhe FKEE-së sipas kësaj marrëveshjeje.

- 7.2 Komuna detyrohet të paraqesë çdo situatë të konfliktit aktual ose të mundshëm të interesit që ndikon në aftësinë e Komunës për t'i shërbyer interesit më të mirë të projektit ndaj FKEEsë dhe Kontraktorëve të tij, ose që mund të përceptohet në mënyrë të arsyeshme që mund të ketë efekt.
- 7.3 Të dyja palët sigurojnë zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi që rregullon parandalimin e konfliktit të interesit.

NENI 8

Dispozitat përfundimtare

8.1 Barazia dhe Mirëbesimi

- 8.1.1 Palët marrin përsipër të veprojnë me mirëbesim në lidhje me të drejtat e njëri-tjetrit sipas kësaj marrëveshjeje dhe të miratojnë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar realizimin e objektivave të kësaj marrëveshjeje.
- 8.1.2 Të dy palët e kuptojnë plotësisht këtë marrëveshjeje dhe kushtet e përcaktuara në të, dhe e nënshkruajnë atë me vullnet të lirë pa ndonjë detyrim ose kërcënim apo ndonjë formë tjetër që ka të bëjë me autorizim dhe miratime, nëse është e nevojshme, për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

8.2 Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 8.2.1 Kjo marrëveshje rregullohet nga Ligjet e Republikës së Kosovës. Çdo mosmarrëveshje ose ndryshim që del nga kjo marrëveshje zgjidhet nga Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës.
- 8.2.2 Palët do të mundohen të zgjidhin çdo mosmarrëveshje miqësisht me konsultime të ndërsjella;
- 8.2.3 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve që lind ose lidhet me këtë marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore mund të referohet nga secila palë në gjykim/arbitrazh në përputhje me juridiksionin e Republikës së Kosovës.
- 8.2.4 Nëse njëra palë kundërshton ndonjë veprim ose mosveprim të palës tjetër, ajo mund të paraqesë një njoftim me shkrim të mosmarrëveshjes palës tjetër duke dhënë në detaje bazën e mosmarrëveshjes. Pala që merr njoftimin e mosmarrëveshjes do ta shqyrtojë atë dhe do të përgjigjet me shkrim brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit. Nëse pala nuk arrin të përgjigjet brenda 14 ditëve, ose mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet miqësisht brenda 14 ditësh pas përgjigjes së asaj pale, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të zbatohen.

8.3 Komunikimi ndërmjet palëve

- 8.3.1 Të gjitha dokumentet që do të sigurohen ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë në gjuhën Shqipe ose në atë Serbe (sipas dakordimit të palëve).
- 8.3.2 Çdo komunikim që kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet në përputhje me këtë marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë kur i dorëzohet personalisht përfaqësuesit të autorizuar të palës së cilës i drejtohet komunikimi, ose kur i dërgohet palës në adresën e specifikuar në marrëveshjeje ose në adresën e postës elektronike të palës.

8.4 Konfidencialiteti

- 8.4.1 Palët bien dakord të mos zbulojnë asnjë informacion në lidhje me kontratën, përveç rasteve të parashikuara nga kjo marrëveshje dhe nga legjislacioni i Kosovës. Sipas marrëveshjes, të gjitha vizatimet, specifikimet, raportet, modelet, materialet elektronike dhe dokumente të tjera të ngjashme do të jenë pronë e Komunës. Të gjitha dokumentet e përmendura mund të përdoren nga FKEE dhe të publikohen vetëm për qëllime informuese të projektit.
- 8.4.2 Përveç me pëlqimin paraprak me shkrim të Komunës, FKEE dhe/ose ndonjë nga Kontraktorët e tij, nuk do të komunikojë në asnjë kohë me asnjë person ose entitet ndonjë informacion konfidencial të marrë gjatë rrjedhës së Shërbimeve, apo edhe FKEE dhe/ose Kontraktorët e tij nuk do t'i bëjnë publike rekomandimet e formuluara gjatë, ose si rezultat, i Shërbimeve;
- 8.4.3 E njëjta gjë vlen për Komunën e cila në asnjë kohë nuk do t'i komunikojë asnjë personi ose subjekti asnjë informacion konfidencial të marrë gjatë Shërbimeve, poashtu Komuna nuk do t'i bëjë publike rekomandimet e formuluara përgjat procesit, ose si rezultat i Shërbimeve.

8.5 Efektiviteti i Marrëveshjes

- 8.5.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve.
- 8.5.2 Kohëzgjatja e marrëveshjes përfundon pas përfundimit të të gjitha punimeve, me pranimin teknik final të punëve e cila realizohet pas periudhës 1 vjeçare pas implementimit të masave.

8.6 Forca madhore

Termi forcë madhore mbulon çdo ngjarje të paparashikueshme, që nuk janë brenda kontrollit të asnjërës palë në këtë rast, dhe të cilën duke ushtruar kujdesin e duhur, asnjëra palë nuk është në gjendje të kapërcej. Mospërmbushje e detyrimeve kontraktuale nuk do të konsiderohet asnjë situatë ku palëve iu pamundësohet përmbushja e detyrimeve nga rrethanat të shkaktuara nga forca madhore. Në kontekstin e kësaj Marrëveshje, përfundimi i financimit nga Qeveria e Kosovës ose donatorët mund të konsiderohet si një ngjarje e forcës madhore.

8.7 Kjo marrëveshje është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale në shqip (ose serbisht), ku një kopje do t'i jepet FKEE-së, dhe një kopje Komunës. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.


SHTOJCA

Si pjesë integrale të Marrëveshjes konsiderohen shtojcat si vijon:

1. Shtojca 1. Përkufizimet
2. Shtojca 2. Përmbledhje e informacionit teknik, konsumi bazë i energjisë dhe masat e efijencës së energjisë (MEE) të zbatuara sipas kësaj marrëveshje.
3. Shtojca 3. Detajet mbi Masat e Efijencës së Energjisë (MEE).
4. Shtojca 4. Kontratat midis FKEE dhe Kontraktorëve për Shërbime të ndryshme dhe për Punimet dhe tabela përmbledhëse

5. Shtojca 5. Plani i Zbatimit të Projektit (Plani Dinamik) – dergohet nga menaxheri i kontrates pas miratimit të tij.
6. Shtojca 6. Detajet lidhur me pagesën e pjesës së bashkë financimit nga Komuna, në vlerë 10% të vlerës së përgjithshme projektit.

Për Komunën:



Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit/
Glllogocit



Për FKEE:



Driton Hetemi
Drejtor Menaxhues i FKEE-së



Datë: 01/11/2024

Shtojca 1. Përkufizimet

Përveç nëse konteksti kërkon ndryshe, terminologjia e mëposhtëme kurdo që përdoret në këtë Marrëveshje kanë kuptimet si në vazhdim:

- 1) "Marrëveshja" Marrëveshja për Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në Pronësi të Komunës
- 2) "Masa për Eficiencën e Energjisë" nënkupton të gjitha masat teknike dhe jo-teknike të zbatuara gjatë gjithë ekzekutimit të PKEE në objektin në fjalë me qëllim përmirësimin e performancës së energjisë.
- 3) "Auditim i Energjisë" do të thotë vlerësimi i masave të mundshme të eficiencës së energjisë, përcaktimi i kushteve bazë të energjisë dhe vlerësimi i konsumit të energjisë dhe kursimeve të parashikuara të energjisë, dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë së tyre financiare (periudha e thjeshtë e shpagimit).
- 4) "Punë" nënkupton punimet, duke përfshirë pajisjet dhe materialet, që do të kryhen nga kontraktori i FKEE-së në përputhje me Kontratën e nënshkruar për objektin në fjalë.
- 5) "PKEE" - Projekti Komunal i Eficiencës së Energjisë
- 6) "Ndërtesë" do të thotë ndërtesa publike komunale, në këtë rast ndërtesa shumë banesore sociale ku zbatohet projekti sipas kësaj Marrëveshje.
- 7) "Komisionimi i projekteve" - vlerësim i punëve të kryera në mënyrë që të sigurohet nëse një projekt është kryer sipas projektit detal dhe specifikacionit teknik në kontratë.
- 8) "Forcë madhore" - ngjarje e cila është përtej kontrollit të palëve në këtë Marrëveshje, nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme e cila pamundëson përmbushjen e detyrimeve nga palët në marrëveshje.
- 9) "NSHSB"- Ndërtesa Shumë-Banesore Sociale

Shtojca 2. Përmbledhje e informacionit teknik, konsumi bazë i energjisë dhe masat e eficiencës së energjisë (MEE) të zbatuara sipas kësaj Marrëveshje.

- Titulli i institucionit
- Informacioni i kontaktit
- Karakteristikat kryesore teknike (përshkrim i shkurtër i ndërtesave, mureve, çatisë, papafingo, ngrohje, ftohje, ndriçim, ujë të nxehtë)
- Parametrat kryesor operacional që nxisin konsumin e energjisë (zona, numri i përfituesve, orët e funksionimit, ditët, ditët boshe)
- Konsumi bazë i energjisë (vjetore dhe mujore)
- Parametrat bazë (temperatura mesatare e jashtme gjatë sezonit të ngrohjes, temperatura mesatare e brendshme gjatë sezonit të ngrohjes)
- Vështrim i përgjithshëm i MEE-ve të zbatuar në kuadër të kësaj Marrëveshje (zëvendësimi i dritareve, zëvendësimi i sistemit të ngrohjes, izolimi i mureve, etj)
- Potenciali i kursimit të energjisë (%)
- Kursime vjetore të energjisë (energji elektrike, gaz, lëndë djegëse të tjera)
- Kursimet vjetore të kostos së energjisë (Euro)
- Investimet e vlerësuara (Euro)
- NPV

Shtojca 3. Detajet mbi Masat e Eficiencës së Energjisë (MEE)

Tabela e Paramasave dhe Paralogaria e kontraktuar duke përfshirë shumat në EUR
(përfshihet pas nënshkrimit të kontratës për secilin nën projekt)

Shtojca 4. Kontratat midis FKEE dhe Kontraktorëve për Shërbime të ndryshme dhe për Punimet

-Kontrata e ndërtimit me Paramasë dhe Paralogari, (kjo marrëveshje nënshkruhet përmes paramasës dhe paralogarisë të fituesit të shpallur dhe kontrata bashkangjitet pas kryerjes së detyrimeve të komunës dhe nënshkrimit të kontratës për secilin nen projekt)

-Kontrata dhe kostot e kontraktorëve për auditimin e energjisë, projektimin teknik, punimet, mbikëqyrjen teknike dhe vënien në punë.

Tabela e përmbledhur:

Nr	Projekti	Vlera totale e projektit [Euro]	Vlera e financimit nga FKEE-90% [Euro]	Vlera 10% e bashkëfinancimit nga Komuna [Euro]	Afati i përmbushjes së obligimit nga Komuna Komuna
1.	Zbatimi i Masave të Efiçencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë-Banesore Sociale II-Drenas	210,824.80	189,742.32	21,082.48	

Shtojca 5. Plani i Zbatimit të Projektit (Plani Dinamik)
(përfshihet pas nënshkrimit të kontratës për secilin nën projekt)

Shtojca 6. Detajet lidhur me pagesën e pjesës së bashkë financimit nga Komuna, në vlerë 10% të vlerës së përgjithshme projektit.

Nr	Kontrata/Fushëveprimi	Kontraktori	Vlera [Euro]	Vlera 10% [Euro]
1	Auditimi i Energjisë, modelet teknike, mbikëqyrja, komisionimi dhe periudha e DLP	Studio Links 4	13,800.00	1,380.00
2	Punët për zbatimin e MEE	Grup i Operatorëve Ekonomik IoT Smart & Green SH.P.K.; UDHA SHPK; ELEGANCA - COM SH.P.K.	197,024.80	19,702.48
Totali			210,824.80	21,082.48